



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1753 Prot.

Rrëshen më, 14 . 04 . 2025

**R A P O R T
I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË MIRDITË PËR
VITIN 2024**

Paraqitur për njohje e shqyrtim, në mbledhjen e datës 25 Prill 2025, të Këshillit bashkiak Mirditë.

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Mirditë, për vitin 2024, ka patur bashkëpunim të mirë dhe punë intensive në vendimmarrje, duke marrë parasysh edhe kërkesat e paraqitura nga qytetarët për t'ju dhënë zë atyre, bazuar në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar dhe Vendimin nr. 35, datë 10.04.2020, të Këshillit Bashkiak Mirditë, "Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkisë Mirditë"

Këshilli Bashkiak, ka tre role kryesore:

- 1. Përfaqësues,**
- 2. Vendimmarrës,**
- 3. Mbikëqyrës**

Për secilin nga këto role të Këshillit Bashkiak po ju citojmë aktivitetet e kryera si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me rolin përfaqësues të Këshillit për vitin 2024;

Është synuar një komunikim dhe transparencë e vazhdueshme me komunitetin, duke publikuar në rrjetin social Facebook dhe në faqen zyrtare; <https://bashkiamirdite.gov.al/sq/keshillibashkiak>, në kohën e duhur njoftimin për çdo mbledhje duke vënë në dispozicion të gjitha projekt-vendimet e rendit të ditës

Konsultimet Publike – viti 2024

Këshilli Bashkiak Mirditë ka organizuar e zhvilluar konsultimet publike për projekt-vendimet në pëpëthje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi

U realizuan Konsultimeve Publike gjatë vitit 2024, si më poshtë vijon;

- Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor
- Plani i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027
- Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- Ndryshime / Shtesa në Paketën Fiskale Vendore të Bashkisë Mirditë
- Buxheti i Bashkisë për vitin 2025 dhe Dokumentit Përfundimtar të Projektbuxhetit Afatmesëm 2025-2027

Takimet publike janë mbajtur dhe pasqyruar në faqen zyrtare dhe rrjetin social FB të Bashkisë/Këshillit Bashkiak Mirditë;

- Përfaqësues të Këshillit Bashkiak Mirditë,
- Qytetarë dhe banorë të njësive administrative respektive të Bashkisë
- Përfaqësues të Grupeve të Interesit

Gjatë takimeve janë respektuar procedurat në zbatim të ligjit duke përfshirë;

- Mbajtjen e procesverbaleve,
- Listat e prezencës,
- Dokumentimin me foto

2. Në lidhje me rolin vendimmarrës, janë kryer aktivitetet si më poshtë vijon;

Gjatë vitit 2024 janë relaizuar në total 13 mbledhje Këshilli, 12 prej tyre të radhës dhe 1 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë

Komisionet e Këshillit Bashkiak janë mbledhur **12 (dymbëdhjetë)** herë

- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës; datë **19.02.2024**, 4 (katër) anëtarë nga 7 (shtatë), datë **13.03.2024**, 5 (pesë) anëtarë nga 7 (shtatë), datë **29.05.2024**, 5 (pesë) anëtarë nga 7 (shtatë), datë **23.09.2024**, 7 (shtatë) anëtarë, datë **28.10.2024**, 5 (pesë) anëtarë nga 7 (shtatë), datë **03.12.2024**, 7 (shtatë) anëtarë, datë **24.12.2024**, 6 (gjashtë) anëtarë nga 7 (shtatë)
- Komisioni i Bujqësisë, Shëndetit Publik dhe Pyjeve; datë **19.02.2024**, 4 (katër) anëtarë nga 5 (pesë) datë **24.04.2024**, 3 (tre) anëtarë nga 5 (pesë)
- Komisioni i Mandateve dhe Çeshtjeve Juridike, datë **29.05.2024**, 3 (tre) anëtarë nga 5 (pesë)
- Komisioni i Arsimit, Sportit dhe Turizmit; datë **23.09.2024**, 2 (dy) anëtarë
- Komisioni i Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës; datë **03.12.2024**, 4 (katër) anëtarë nga 5 (pesë)

Gjithësej janë miratuar **116 vendime nga Këshilli Bashkiak**, nga të cilat:

- **67** vendime të konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë + **20** vendime, Akte me Karkter Normativ, të konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, (gjithësej **87** vendime)
- **28** vendime, Akte me Karkter Individual, (akte që nuk dërgohen për konfirmim te Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë)
- **1** Vendim (**VKB nr. 99, datë 04. 12. 2024**), **Akti me Karakter Normativ i pa-konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë**, i cili ky Vendim u **rishqyrtua** në mbledhjen Këshillit Bashkiak të datës 27.12.2024 (**VKB nr. 111, datë 27.12.2024, “Mbi rishqyrtimin e VKB nr.99, datë 04.12.2024”**) i cili u **konfirmua nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë**

Gjithashtu, kemi miratuar planin e punës të shoqëruar me planin e konsultimeve dhe buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin, me qëllim realizimin e gjithë aktiviteteve të parashikuara

Falë mbështetjes së projektit “Bashki të Forta”, nëpërmjet dhurimit të paisjeve teknologjike, Këshilli i Bashkisë Mirditë ka transmetuar live mbledhjet e Këshillit Bashkiak, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjet

Janë realizuar dy trajnime;

- ✓ Përfaqësues të komisioneve të Këshillit Bashkiak Mirditë, kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen Vendore (AMVV), në bashkëpunim me Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV), Shkolla Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqata e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), me suportin e projektit “Bashki të Forta” (BtF) i cili financohet nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Helvetas, u organizua trajnimi për Komisionet e Përhershme të Këshillit të Bashkisë, në kuadër të përpjekjeve për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për të fuqizuar organet e tyre vendimmarrëse përmes rritjes së kapaciteteve të këshilltarëve vendor

Qëllimi i trajnimit ka konsistuar në fuqizimin e rolit të Komisioneve të Këshillave Bashkiake në shqyrtimin e projekt-akteve, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raporteve për propozimet ndaj këshilltarëve në seancën e këshillit, me qëllim krijimin e këshillave të suksesshëm, që mwe rolin e tyre në mbështetje të administratës së Bashkisë dhe nëpërmjet angazhimit të qytetarëve, do të arrijnë të përmirësojnë sa më shumë demokracinë vendore dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike

- ✓ Drejtues të Këshillit Bashkiak Mirditë, kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në kuadër të iniciativës Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen Vendore (AMVV)

Këto trajnime u zhvilluan në bashkëpunim dhe koordinim me Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV), Shkollën Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqata e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), me suportin e projektit “Bashki të Forta” (BtF) i cili financohet nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Helvetas

Ky trajnim, si vazhdim i trajnimit përgatitor për këshilltarët e rinj dhe komisionet e këshillave, u fokusua në rritjen e kapaciteteve menaxhuese të drejtuesve të këshillave bashkiakë, të cilat kanë përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen dhe kryerjen e detyrave ligjore të Këshillit

Trajnimi u fokusua te Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes, aktet që rregullojnë veprimtarinë e brendshme dhe Konsultimet me Publikun, menaxhimi vendor dhe buxheti i Këshillit

- Akteviteti sensibilizues dhe ndërgjegjësues në kuadër të “**Tetorit Rozë**”, ardhur si nismë e Alencës së Grave Këshilltare, Komisioni i Barazisë Gjinore, Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Biznesit, Bashkisë Mirditë, njësitë vendore të Kujdesit Shëndetësor, me pjesëmarrjen e gjërë të garve, vajzave dhe banorëve mirditor

Gjatë këtij aktiviteti u ndanë informacione me vlerë mbi kujdesin, kontrollet, parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit

Vlen të përmendet, puna e palodhur dhe e suksesshme Komisionit të Barazisë Gjinore, Gartë Këshilltare, Znj. **Marjana Molla**, Znj. **Marjana Prenga** & Znj. **Rigerta Loku**

Shpenzimet nga buxheti i këshillit janë zero, dhe trashëgohen për vitin 2025;

- Buxheti për realizimin e një vizite studimore me pjesëmarrjen e Këshillit Bashkia dhe përfaqësues të Bashkisë, në një Këshill/Bashki homologe jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e marrdhëneve për

bashkëpunim të ndërsjellë në të ardhmen, **nuk u realizue**, për arsye të afateve kohore procedurale, pavarësisht punës paraprake me komunikimet online

3. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit;

Nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e Këshilltarëve në drejtim të administratës, në rastin e shqyrtimit të projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi

Këshilli Bashkiak, duhet të kërkojë administratës, raporte sqaruese, çdo tre muaj, mbi ecurinë dhe ekzekutimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli

- **Të gjitha vendimet e këshillit bashkiak, janë publikuar në faqen zyrtare Bashkisë Mirditë, <https://bashkiamirdite.gov.al> dhe janë të aksesueshëm nga çdo qytetar pa pagesë**

Është pasuruar në faqen zyrtare të Bashkisë Mirditë, informacionet e Këshillit Bashkiak për publikun nëpërmjet kartelave/tabelave të mëposhtëme:

- Kryetari i Këshillit - kontaktet
- Sekretari i Këshillit - kontaktet
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak - kontaktet
- Kryetarët e Fshatrave të Bashkisë - kontaktet
- 5 Rregulloret e Këshillit Bashkiak
- Kalendari i Konsultimit Publik
- Njoftimi i konsultimit publik
- Vendim i miratimit të planit të aktiviteteve dhe buxhetit të këshillit (Plan+buxhet këshilli)
- Rregjistri i kërkesë ankesave
- Rregjistri i brendshëm i peticioneve
- Rregjistri i mbledhjeve të këshillit
- Konsultime Publike
- Raportet e Komisioneve të Këshillit Bashkiak

Nga Sekretariati i Këshillit është vënë në zbatim kërkesat e ligjit për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të Bashkisë, Drejtorëve të bashkisë), në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë, por në të ardhmen do të bëhet e mundur jo vetëm njoftimi në faqen e Bashkisë apo në media vendore por edhe njoftimeve e shpalljeve në të gjitha njësitë administrative e lagjet e qytetit, ku për këtë është e nevojshme mbështetja nga nëpunësit e njësive administrative.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen; gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimarrje të komunitetit.

Administratorët e lagjeve dhe të njësive administrative, kryesitë e fshatrave, këshillat komunitare, duhet të bëhen pjesë e organizimit e mbështetjes së dëgjësave publike, ku nëpërmjet posterave, anketave të ndryshme do të bëhet e mundur tërheqja e mendimit të komunitetit dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje

Del si detyrë që çdo këshilltar; për aktet normative, të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të

Për sa më sipër, vlerësojmë përvojën pozitive dhe ndërkohë kërkojmë plane tuaja për dëgjesa në zonat ku banoni apo jeni caktuar për të kryer detyrën e këshilltarit

Falenderimet, shkojnë për;

- Falenderojmë Kryetarin e Bashkisë Mirditë Z. **Albert Mëlyshi**, për bashkëpunimin dhe prezencën e tij, veçanarisht në mbledhjet e Komisioneve të Këshillit
- Falenderojmë, administratën e Bashkisë Mirditë dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në veçanti Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, Agjencinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Agjencinë e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Sociale, Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave, Protokollin dhe Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun
- Falenderojmë, Asistenten e Këshillit Bashkiak, Znj. **Lindita Zefi**, për punën, korrektesën dhe përkushtimin e saj, në mbarëvajtjen e dokumentimit të saktë të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme dhe të Këshillit Bashkiak Mirditë
- Falenderojmë Znj. **Artilda Laska**, për publikimet e gjithë vendimeve dhe dokumenteve shoqërues në web-in e Bashkisë dhe të palodhurin Z. **Edmond Dodaj** për transmetimet online të mbledhjeve të Këshillit në mënyrë korrekte dhe profesionale
- Falenderojmë për asistencën teknike dhe operacionale të Z. **Bukurosh Onuzi**, koordinator i projektit “Bashki të Forta”

Ndërveprimi i Këshillit Bashkiak me qytetarët, në rrjetet sociale, të nxjerra në mënyrë garfikike dhe “Analiza e statistikave të përgjithshme për faqen e Këshillit Bashkiak Mirditë”, pjesë përbërse e këtij raporti, bashkëlidhur

Faleminderit !

Hartoi raportin:

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Gaspër TOPOLLAJ




Top content formats

↓ Eksporito ▼

Published content


Based on up to 200 pieces of content

+51,2% vs. 31 Dhj 2022 - 31 Dhj 2023




Facebook reach

-89,4% vs. 31 Dhj 2022 - 31 Dhj 2023



Content interactions

-24,1% vs. 31 Dhj 2022 - 31 Dhj 2023




Content overview


Breakdown: Organic/ads

Të gjitha Posts Stories Reels Videos Live


Views **Mbulimi** 57,6 mijë 7,3 mijë 22,9 mijë 6,6 mijë 3,2 mijë
↓ 89,4% ↓ 68,4% ↓ 54,7%



Qytetet kryesore



Shtetet kryesore




Followers

Për të gjithë kohëzgjatjen

1376

Age & gender



ANALIZA E STATISTIKAVE TË PËRGJITHSHME PËR FAQEN "KËSHILLI BASHKIAK MIRDITË"

Përmbajtja e Publikuar;

Gjatë periudhës së raportuar, faqja ka publikuar një gamë të gjerë materialesh:

- **88 foto**, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të postimeve
- **18 video dhe 13 transmetime live**, duke treguar një përpjekje për angazhimin vizual.
- **2 postime me linke dhe 2 postime me tekst**, që janë më të kufizuara
- **1 Reels**, duke eksperimentuar me formatin e shkurtër të videove

Ndërveprimet me Përmbajtjen;

- **Linket** kanë marrë angazhimin më të madh, me **1060 ndërveprime**, duke treguar interes të ndjekësve për informacion të jashtëm ose dokumente zyrtare
- **Videot** kanë gjithashtu një ndërveprim të lartë, me **931 ndërveprime**, duke sugjeruar se përmbajtja vizuale është tërheqëse për audiencën
- **Fotot (591 ndërveprime)** dhe **Live (527 ndërveprime)** gjithashtu kanë një ndikim të rëndësishëm
- **Stories (135 ndërveprime)** dhe **postime me shumë foto (1 ndërveprim)** kanë angazhimin më të ulët, duke sugjeruar nevojën për strategji të tjera për t'i bërë më efektive

Mbulimi i Përmbajtjes;

- **Videot** kanë pasur mbulimin më të madh, me **5157 shikime**, duke konfirmuar rëndësinë e përmbajtjes dinamike
- **Fotot kanë arritur 3595 përdorues**, duke pasur një ndikim të fortë.
- **Përmbajtjet e tjera (1895)** dhe **Live (1615)** tregojnë interes mesatar.
- **Linket (1347)** dhe **postimet me shumë foto (260)** kanë pasur një mbulim më të kufizuar.
- **Tekstet (98)** dhe **Multimedia (23)** kanë pasur ndikimin më të vogël.

Përhapja e Përmbajtjes (Reach Breakdown);

Gjatë periudhës **1 Janar 2024 - 31 Dhjetor 2024**, faqja ka pasur:

- **7260 shikime në total**, duke pësuar një rënie prej **89.4%** krahasuar me periudhën **2022-2023**

- **7140 shikime organike**, duke reflektuar një rënie të ngjashme prej **89.3%**

Përfundime dhe Rekomandime;

1. **Shtimi i përmbajtjes video dhe live**, pasi kanë mbulim dhe ndërveprim të lartë. Një rritje në numrin e videove mund të ndihmojë në rikthimin e angazhimit
2. **Rishikimi i strategjisë për linket**, duke u fokusuar në përmbajtje tërheqëse që gjeneron më shumë klikime dhe diskutime
3. **Optimizimi i Stories dhe Reels**, pasi kanë potencial të madh për rritje të shikueshmërisë dhe ndërveprimit
4. **Promovimi i përmbajtjes përmes sponsorizimeve**, për të kundërshtuar rënien e shikueshmërisë organike dhe për të arritur një audiencë më të gjerë

Duke ndjekur këto hapa, faqja "Këshilli Bashkiak Mirditë" mund të rrisë ndikimin e saj dhe të forcojë lidhjen me komunitetin

Analiza e Audiencës së Faqes "Këshilli Bashkiak Mirditë"

Demografia e Audiencës;

Faqja "Këshilli Bashkiak Mirditë" tërheq një audiencë kryesisht të përbërë nga meshkuj (dominues në të gjitha grupmoshat) dhe një përqindje më të ulët të femrave. Më konkretisht:

- **Mosha 35-44** përbën grupin më të madh të ndjekësve, me **19.6% meshkuj dhe 5.8% femra**, duke treguar një interes të shtuar të rriturve aktivë në vendimmarrjen lokale.
- **Mosha 25-34 dhe 45-54** gjithashtu kanë një prani të konsiderueshme, duke treguar një angazhim të fortë nga brezat e rinj dhe të mesëm
- **Grupmosha mbi 65 vjeç** ka numrin më të ulët të ndjekësve, çka sugjeron nevojën për strategji komunikimi më të përshtatshme për këtë segment

Vendbanimi i Audiencës;

Ndjekësit e faqes janë të shpërndarë në disa qytete kryesore, ku dominon **Rrësheni (24.7%) dhe Tirana (24.3%)**, pasuar nga Lezha (6.1%) dhe Durrësi (3.9%). Ky përfaqësim tregon një interes të lartë nga komuniteti lokal dhe diaspora e Mirditës në Tiranë

Përfaqësimi Ndërkombëtar;

Ndjekësit vijnë kryesisht nga **Shqipëria (78.1%)**, por faqja ka një shtrirje të konsiderueshme edhe jashtë vendit, kryesisht në **Itali (7.4%), Greqi (3.1%), dhe Gjermani (2.3%)**. Prania e ndjekësve nga Mbretëria e Bashkuar, SHBA dhe vende të tjera tregon interesin e diasporës për zhvillimet në Mirditë

Përfundim dhe Rekomandime;

- **Fokusi në grupmoshën 35-44:** Kjo moshë është më e përfshirë, ndaj përmbajtja mund të fokusohet në temat që lidhen me vendimmarrjen dhe zhvillimin e komunitetit.
- **Angazhimi i femrave:** Duke qenë se pjesëmarrja e femrave është më e ulët, mund të promovohen më shumë iniciativa që synojnë përfshirjen e tyre në çështjet lokale.
- **Përfshirja e diasporës:** Duke parë interesin e madh nga Italia, Greqia dhe Gjermania, përmbajtja mund të përfshijë më shumë informacione mbi projektet për diasporën dhe zhvillimin e Mirditës.
- **Komunikimi në qytetet kryesore:** Përveç Rrëshenit dhe Tiranës, mund të ketë një fokus të veçantë në Lezhë dhe Durrës, ku është e pranishme një pjesë e konsiderueshme e audiencës.

Ky raport mund të ndihmojë në përcaktimin e strategjive më efektive për rritjen e ndërveprimit dhe angazhimit në faqen "Këshilli Bashkiak Mirditë".